



MINISTRJA XHAÇKA NË SAMITIN "PLATFORMA E KRIMESË": TË MBËSHTESIM UKRAINËN NË MËNYRË QË AGRESIONE TË TILLA TË PALIGJSHME TË MOS PËRSËRITEN MË

MEPJ Olta Xhaçka, mori pjesë në samitin virtual "Platforma e Krimesë" të kryesuar nga Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky. Në fjalën e saj ajo tha se Shqipëria ka mbështetur Ukrainën dhe rezistencën e saj, duke qenë një nga vendet e para që dërgoi municione, duke kontribuar në Konferencën e Donatorëve, duke miratuar ligjin kornizë që mirëpret ukrainasit që ikin nga lufta, duke u rreshtuar plotësisht me sanksionet e BE-së dhe duke bërë maksimumin në Këshillin e Sigurimit, si bashkëpunëmbajtës me SHBA.



PËRVJETORI I PAVARËSISË, MINISTRJA XHAÇKA: KRENARE PËR GJITHÇKA SHQIPËRIA KA BËRË PËR UKRAINËN DHE POPULLIN E SAJ

MEPJ Olta Xhaçka, mori pjesë në ekspozitën fotografike "Kronika të pushtimit rus të Ukrainës – fillesat" që u mbajt me rastin e 31-vjetorit të pavarësisë së Ukrainës. Ministria Xhaçka theksoi se Shqipëria do të vazhdojë të japë kontributin e saj në mbështetje të Ukrainës dhe shprehu krenari për gjithçka që kemi bërë për të mbështetur Ukrainën dhe popullin e saj dhe kontributin e dhënë për përfundimin e luftës.



MARRËVESHJA PËR SIGURIMET SHOQËRORE MES SHQIPËRISË DHE ZVICRËS, DREJT FINALIZIMIT

Marrëveshja për sigurimet shoqërore mes Shqipërisë dhe Zvicrës mbërrin për miratim në Kuvendin e Zvicrës. Falë punës disa vjeçare të qeverisë shqiptare me institucionet zvicerane është garantuar trajtimi barabartë i të siguruarve si dhe do të evitohen rastet e taksimit të dyfishtë apo abuzimeve në të dy vendet.



SHËRBIMET KONSULLORE PËR MUAJIN GUSHT 2022

Përgjatë muajit gusht 2022 nëpërmjet platformës SHKO, janë ofruar 12104 shërbime konsullore. Nga këto 7906 janë shërbime për Pasaporta dhe Karta ID dhe 3569 për Leje Kalimi. Zyra e legalizimeve në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme për gjatë këtijmuaji ka ofruar 79,061 legalizime.



MINISTRJA XHAÇKA TAKON AMBASADOREN E BE-SË CHRISTIANE HOHMANN

MEPJ Olta Xhaçka, ka zhvilluar një takim me Ambasadorën e re të Bashkimit Evropian në Shqipëri, Christiane Hohmann. Ministria Xhaçka dhe Ambasadorja Hohmann diskutuan për rrugëtimin që e pret Shqipërinë pas hapjes formale të negociatave me BE dhe për bashkëpunimin me Ambasadorën dhe Delegacionin e BE në Shqipëri për të çuar përpara procesin e negociatave.